


VELGISHI FAMILION H



Maksut Vezgishi

Pavilioni K

Maksut Vezgishi

PAVILION K

Kuruar nga / Curated by
Matilda Odobashi

05.09.2018 – 01.10.2018

Katalogu - Catalogue:

Botues – Publisher:

Galeria Kombëtare e Kosovës
National Gallery of Kosovo

Tekstet / Text:
Matilda Odobashi, Shkëlzen Maliqi, Tevfik Rada, Arleta Čehić

Fotografitë / Images:
Enver Bylykbashi

Përkthimi dhe lektura / Translation and proofreading:
Jehona Xhaferi

Dizajni / Design:
Trembelat

Shtypi / Print
VIPRINT

Viti / Year: 2018

Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje nga Ministria e Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve / The Exhibition And Catalogue Are Supported by the
Ministry of Culture, Youth and Sports:



Sponzorë Medial / Media Sponsors:



Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës- National Gallery of Kosovo staff:
Arta Agani, Drejtoreshë -Director; Zeni Ballazhi, Kurator-Curator; Mexhide
Maxhuni, Zyrtare për financa -Finance officer; Lirije Buliqi, Zyrtare e lartë
administrative -Senior administrative officer; Naim Spahiu, Koordinator për
ekspozita -Coordinator for exhibitions; Enver Bylykbashi, Fotograf profesional
-Professional photographer; Engjëll Berisha, Koordinator për bashkëpunim
ndërkombëtar dhe MR/ coordinator for international cooperation and PR Skender
Xhukolli, Teknik për ekspozita -Exhibition technician; Rrahman Bislami, Teknik për
ekspozita/Mirëmbajtës i objektit -Exhibition technician /Building caretaker; Xhevat
Rrahimi, Kujdestar i sallës ekspozuese -Exhibition hall attendant; Valdet Sylja &
Mentor Abdullahu, roje nate -security guards

PAVIJON K

Matilda Odobashi

Sipas studiuesit të masmedias dhe komunikimit Friedrich Kittler, “ajo çka mbetet nga njeriu është ajo çka media ruan dhe komunikon për të”.

A qëndron ky pohim edhe për “mediat sociale” vende ku sot lindin dhe farkëtohen njohje dhe miqësi të reja? Ç’ndodh më pas, nëse njëri ose të dy bashkëbiseduesit shköputen nga kjo hapësirë virtuale? Në më të mirën e rasteve ndodh takimi tek realja.

Maksutin e kam njohur dhe kam komunikuar së pari në hapësirën e paskajshme virtuale, nga ku më pas unë vendosa mos të jem më pjesë. Pas disa kohësh që komunikoni virtualisht u mundësua një takim në botën reale. Qysh prej takimit të parë sy më sy, zuri fill edhe bashkëpunimi ynë, i cili ka kaluar nëpër disa etapa, e që më së fundi vjen në Pavijon-in K.

Qysh në krye të herës, ajo që më tërhoqi nga krijimtaria e Maksutit ishte përdorimi i linjave të pastra dhe precize të cilat ai i përdor pors i një shenjë të tijën të identifikimit.

Vezgishi është formuar si arkitekt, piktura ka qenë dashuria e parë në rrugëtimin e tij drejt artit bashkëkohor, ka një histori të gjatë në teatër dhe gjithashtu në periodikët e ndryshëm kulturorë, tek këto të fundit duke kontribuar në disa forma e formate. Pikërisht ky formim i shumanshëm dhe veçanërisht formimi si arkitekt, vihet re edhe në punën e tij krijuese, e më sakte arkitektura është ajo çka luan një rol themelor. Arkitektura në fakt nis me gjeometrinë dhe nga ana e saj gjeometria fjalë për fjalë do të thotë “matja e tokës”. Atëherë nëse në natyrë (planetin tokë përfshirë këtu), forma ideale është sfera dhe kjo e fundit e hedhur në plan bëhet rreth, atëherë Vezgishi ka vendosur si formën e tij ideale të ketë katrorin i cili nëse i brenda-shkruhet rrethit, jep përmasat perfekte.

Tek një ndër veprat e Vezgishit përballemi me një kolazh veshjesh, të zhveshura nga kuptimi i tyre fillestar e të reduktuara në forma gjeometrike, ku mbizotëron katrori suprematist. Katrorin e gjejmë edhe tek trajtat të cilat formojnë FLAG, dhe tek ri-interpretimet në të zezë frymëzuar nga punimet e M. Rothko-s të cilave i janë zhveshur gjithë ngjyrat, në qeskat të cilat mbajnë tullat në vend të bukës apo në portret-peizazhet e lapsit në pëlhurë.

Herë i sjellë i brendashkruar në veshje dhe herë mbi-zotërues në beze, katrori është gjithnjë prezent duke krijuar hapësira/forma/botëkuptime.

E s'kishte si të ndodhte ndryshe, ku tre elementët e sipërpërmendur nuk janë thjesht dhe vetëm rastësore, porse edhe shënjeshtë të një hapësire që quhet Ballkan, vend ku Vezgishi është lindur dhe formësuar.

Herë kompakt nën perandori të mëdha a federata shtetesh e herë i copëzuar në hapësira të vogla me ndasi etno-linguistiko-kulturore, ky kaleidoskop formash që bëhen e zhbëhen në hapësirë e kohë përngjasohet tek vepra e Maksutit në zhbërjen dhe ribërjen e veshjeve/objekteve/trajtave të cilat bash duke u shformësuar, krijojnë diçka të re. Në Pavijon K, tradita ndërthuret me bashkëkohoren në një cohë që përngjan me pëlhurën e Penellopës, e cila e thurte gjatë ditës dhe e zhbënte gjatë natës. Kjo baladë mijëvjeçare Ballkanase sendërgjohet edhe në veprën e Vezgishit.

Ndërsa minimalizmi suprematist në këtë ekspozitë “plotësohet” nga varfëria në material e arte povera-s, kjo i jep asaj trajtën e një koncepti persekutues në zbrazëtinë e tij, të një populli të “varfëruar” materialisht porse që ruan me nostalgji, dhe rievokon kohërat e largëta stërgjyshore të (zh) veshjeve të burrave nga kostumet e tyre të përditshme për t’ju nënshtruar kërkesës së vendit për betejë/luftë për liri. Ekspozita kulmon me K-vendi-n, simboli i udhëheqjes, aty ku vendimet e rëndësishme merren ulur këmbë-kryq me anë të sfungjerëve të kompozuar njëri krah tjetrit e njëri sipër tjetrit. Një odë tashmë e sjellë në formën e saj më minimaliste, e reduktuar thjesht në forma katrore, e zhveshur nga të gjithë elementët folkloristikë, por e pasur me simbolikën e vendimmarrjes dhe të patriarkatit, element i cili është po aq i pranishëm sot sa dhe dje. Kjo ekspozitë është e përshkruar e gjitha nga një simbolikë shumë-anëshe. Secili objekt mbart në vetvete një kuptim të veçantë, ndërsa i venë në marrëdhënie me të tjerët tregon një histori të përbashkët të një vendi. Të vendit prej të cilit Vezgishi u largua në një moshe tashmë të pjekur e formësuar nga traditat të cilat u gdhendën në të ndërgjegjshmen e të pandërgjegjshmen e tij.

Ekspozita në fjalë, e para e tij personale në Kosovë pas

ALB

pothuaj se 40 viteve, na sjell gjithë kulturën shqiptare e shqipfolëse, me gjithë kritikën dhe nostalgjinë që mbart një personi i cili jeton larg por që nuk e humbi asnjëherë marrëdhënien dhe afeksin me vendin e tij. Nga largësia, edhe kënd-vështrimi i ndodhive të vendit të vet i jep një interpretim tjetër të cilin autori dëshiron ta ndaj me publikun e vendlindjes, për të krijuar një bashkëbisedim të ri për të ardhmen, gjithnjë duke kumtuar mbi të shkuarën.

According to Friedrich Kittler, the communication and media scholar, “What remains of people is what media can store and communicate”.

Does this statement stand for “social media” as well, for places where new acquaintances and friendships are born and developed in today’s world? What happens if one or both conversers leave this virtual space? In the best scenario the real meeting in person happens.

Initially, I have met and communicated with Maksut in the vast virtual space, from which, after a while, I decided to move out and not be part of. After some time of communicating virtually, a meeting in real world was enabled. Our cooperation started since the first meeting in person, and went through different phases, where the last one comes in K Pavilion.

What intrigued me, since the beginning, from Maksut’s art work was his use of clean and precise lines which he uses as his identification signature.

Vezgishi was developed as an architect, and painting was his first love in his pursuit towards contemporary art. He has a long history in theatre and in different cultural magazines. His contribution in the latter was in different forms and formats. Exactly this multitude of development, and specifically his development as an architect is noticeable in his creations, while architecture is what has an essential role. In fact, architecture starts with geometry and the literal meaning of geometry is “earth measurement”. Then if the ideal form in nature (including here the planet earth) is sphere and if we put it in a two dimensional plan it becomes a circle, then Maksut decided to have the square as his ideal form, which if inscribed by a circle gives the perfect measures.

In one of Vezgishi’s works we are faced with a collage of clothes, stripped of their initial meaning and reduced in geometrical forms, where the supremacist square prevails. We find the square also in the shapes that form the FLAG, and as well at the reinterpretations in black inspired by the works of M. Rothko, which are stripped of all colours, to the plastic bags which hold the bricks instead of loafs of bread to the portrait-landscapes with pencil in canvas.

K PAVILION

Matilda Odobashi

ENG

Sometimes inscribed in clothes and sometimes supremacist in canvas, the square is always present creating spaces/shapes/beliefs.

And there was no other way, since the three mentioned elements are not just and only by coincidence, but are the markings of a space called Balkans, a place where Vezgishi was born and developed.

This kaleidoscope of shapes, sometimes compact under huge empires or state federations and sometimes cut to pieces in small spaces and ethno-linguistic-cultural divisions, which are done and undone in space and time are resembled in Maksut's art work in undoing and redoing of clothes/objects/shapes which by dis-shaping create something new. In K-Pavilion, the tradition is intertwined with contemporary in a material which resembles the shroud of Penelope, who weaved it during the day and undid it during the night. This ancient Balkan ballade is created in Vezgishi's artwork.

While supremacist minimalism in this exhibition is "fulfilled" by the poorness in material and arte povera, and this gives it the shape of a persecuting concept in its void, of a materially "poor" people but who nostalgically preserve and revoke past predecessor times of (de)clothing of men of their daily costumes to submit to the request from the country for battle/fight for freedom. The exhibition's peak is K-place, the symbol of leadership, where the important decisions are taken while seated cross-legged in foam mattresses composed one next to the other and one on top of the other. An oda brought in its minimalist form, reduced simply in a square shapes, stripped of all its folkloristic elements, but rich with the symbolic of decision-making and patriarchy, an element which is present today as much as it was yesterday. This exhibition is entirely covered by a multi-dimensional symbolic. Each object holds in itself a particular meaning while when put in relation with others shows a joint history of this country. Of the country from which Vezgishi left when he was of the age shaped by the traditions which were carved in his conciseness and sub-conciseness.

This exhibition, the first solo one in Kosovo, after almost 40 years, brings the whole Albanian and Albanian speak-

ing culture, with all the critique and nostalgia a person who lives abroad has inside but who never lost the relation and affection for his country. From afar, and the point of view of events happening in his country, he gives a different interpretation and wants to share it with the audience of his hometown, to create a new conversation for the future, always telling about the past.

Rreth Pavidonit K Shkëlzen Maliqi

Veptra artistike është objekt i parë *sub specie aeternitatis*; dhe jeta e mirë është bota e parë *sub specie aeternitatis*. Kjo është lidhja ndërmjet artit dhe etikës.

Ludwig Wittgenstein, Notebooks 1914-1916

Paviloni K. i Maksut Vezgishit është projekt me dendësi konceptuale. Pikturat dhe vizatimet minimaliste, instalacionet, objektet, seria e kostumeve të çuditshëm mund të shijohen ndaras, por megjithatë, preferenca është që ato të shokohen si instalacion i përbërë, si një tërësi. Dhe kjo përkundër përsh-typjes së pare se disa punë sikur nuk lidhen bashkë, p.sh., nuk ka harmoni mes pikturave minimaliste (Katrori, Kulla, Roth_Ko) dhe kostumeve (Krahët e dëshirës), të varura në seri si qepje të pambaruara ose work in progress në ndonjë punëtori robaqepësie. Po ashtu nuk zbërthehet lehtë as lidhja e dy palë dorezave mbi postamente skulpturash me tituj enigmatike K-tori dhe Smajl Skenderi, dhe instalimit që e zë gjysmën e sallës së galerisë me sfungjera që shtrihen përgjatë mureve (K vendi).

Megjithatë, autori ofron elementin unifikues duke i emërtuar gati të gjitha punët me një K. dalluese. Kjo të çon te supozimi se Pavilonin K. duhet zbërthyer si Paviloni Kosova, ndonëse me rezerva sepse vetë autorit K.-ja mbase i shërben që më shumë të fsheh sesa të zbulon.

K.-ja e Vezgishit ta kujton Jozef K.-në, (anti)heroin e romanit të Franc Kafkës “Procesi” (1925), ku mbiemëri me shkurtersë pasqyron identitetin e mjegullt, gjysmëanonim, shpërfytyrues brenda narrativit që shpalos fatin e një individi të kapur nga makineria e pamëshirshme sociale që atë e ndjek, paditë, gjykon dhe, në fund, e vret si qenin, pa u kuptuar fare arsyeja e katrahurës së tij... Paviloni K.-në është imazh i narrativit të ngjashëm të kapjes të krejt vendit K., ngase edhe fjala tjetër në togfjalëshin, pra paviloni, ti kujton më shumë kuptimet sfilitëse të përdorimeve të saja si pavilon burgu, pavilion spitali ose pavilion çmendine.

Ky interpretim edhe mund të duket subjektiv, hamendësues. Por, edhe pista tjetër e zbërthimit të misterit të K.-së, që është më pranë kontekstit të arteve pamore, edhe pse abstrakte, njëfarëdore të çon në atë drejtim. K.-ja këtu

ALB

është shënnyese e katrorit si një element kyç në krijimtarinë e Vezgishit që nga veprat e para të realizuara si artistit pamor, dhe është i pashmangshëm edhe në vepat e fushave të tjera ku ai është sprovuar si arkitekt, enterierist, regjisor teatri, skenograf, dizajner grafik, etj.

Në Pavilonin K. katrorët janë gjithëprezentë si elemente konstruktive dhe si ndërhyrje aplikuese. Nuk shfaqen vetëm te punët abstrakte në kajden e katrorit të zi apo të bardh të Maleviçit, por edhe në instalacionet ‘jogjeometrike’, p.sh. në kostumet e series Krahët e dëshirës, ku në secilin prej tyre hasim të paktën në një katror që s’është pjesë e qepjes origjinale, por Vezgishi ka ndërhyrë në te, janë qepje shtesë.

Katrorët ‘shtesë’ mund të konsiderohen si citate nga doktrina suprematiste e Maleviç, të cilit Vezgishi i detyrohet në krijimtarinë e tij.¹

Kjo na kthen te pyetja e fillimit mbi lidhjen konceptuale mes pikturave abstrakte (Katrorët, Kulla, Roth_Ko) dhe instalacioneve që nuk mund të reduktohen lehtë në forma gjeometrike? Në të vërtetë, edhe instalacioni K. vendi konstruktohet nga tablotë e mëdha katrorë të sfungjerit si një gjasim me odat shqiptare ku burrat kuvendojnë ulur galiç. Instalacioni Flamuri dhe Tullat; 1969, po kështu i ka katrorët si element konstruktiv. Vetëm se për këto instalacione, si edhe për Krahët e dëshirës, thelbin e tyre duhet kërkuar jo në gjeometri, por në narrativin social që e dominon ekspozitën si tërësi.

Vetë titulli krahët e dëshirës përçon idenë e kuptimit metaforik të ‘sfilatës’ së veshjeve të shekullit XX, sepse ato janë kostume të modernizmit, ose pjesë e gjakimit të shoqërisë që të kapet hapi me civilizimin, por që kjo intencë mbetet gjysmake, e pafinalizuar. Kostumet e instalimit, si elementi më dinamik që e përshkon tërë hapësirën e pavilonit, mishrojnë metaforën e dualitetit: ato janë qepur sipas mostrave të bukura dhe ekspresive, por duken të tr-

1. Ekspozita Paviloni K. në këtë aspekt dallon shumë nga ekspozita paraprake e Vezgishit Bardh në galerinë ‘Zeta’ (Tiranë, 2016), që e tëra ka qenë homazh abstracionit suprematist të Maleviçit. Kalimthi po e përmendi edhe faktin se te ekspozita në ‘Zeta’ Vezgishi e ka ndarë hapësirën me Matilda Odobashin, e cila tani, në Pavilonin K., e ka rolin e kuratores.

ishtueshme dhe të frikshme si ndonjë mbetje e ‘poemës së mjerimit’ nga pamundësia e realizimit. Vezgishi mbase aludon në ‘veshjet’ me ideologji progresiste, premtuese të barazisë dhe lirisë, por që duke ushqyer ambicjen e “inxhinierëve të shpirtrave” dhe te krijimit me çdo kushtë, edhe me dhunë, të “njeriut të ri”, kanë përfunduar si mashtrime kolosale, duke “rrëshqitur” në totalitarizma dhe regjime çnjerëzore.

Paviloni K është muze iluzionesh që pasqyron përpjekjet e shekujve të iluminizmit dhe modernizmit që njeriu ynë të “vishet” në kostume të racionalitetit dhe përparimit me cilësi estetizuese, po që nuk ia ka dal sepse projekti është komprometuar dhe degradur. Degradimin në të sotmën Vezgishi e tregon duke i ironizuar lëndët ndërtuese të saj, si në flamurin e sajuar nga qeset plastike, shtyllës me furniturë koti, “K. vendi” nga sfungjeri artificial. Si në moton e Uitgenshtajnit që e keni në krye të shkrimit, edhe te Paviloni K. na duket legjitim leximi i tij sa artistik po aq edhe etik.

The work of art is the object seen *sub specie aeternitatis*; and the good life is the world seen *sub specie aeternitatis*. This is the connection between art and ethics.

Ludwig Wittgenstein, Notebooks 1944-1916

About Pavilion K
Shkëlzen Maliqi

Maksut Vezgishi's Pavilion K is a project with conceptual density. Minimalist paintings and drawings, installations, objects, the series of weird costumes may be enjoyed separately, however, it is preferred they are viewed as a joint installation, as a whole. And this is contrary to the first impression one gets that some works are not connected at all, for e.g. there is no harmony between minimalist paintings (Square, Tower, Roth-Ko) and costumes (Wings of Desire), hung in a series as unfinished sewing or work in progress in some kind of a sewing workshop. In the same way it is hard to define the link between the two pairs of gloves put on a sculpture plinth with enigmatic titles K-tori and Smajl Skenderi, and the installation which takes half of the gallery room with sponge mattresses lying along the walls (K place).

Nevertheless, the author offers the unifying element, naming almost all works with the distinguishing K. This leads to the assumption that Pavilion K should be analysed as Pavilion Kosova, although with some limitations because it seems that K serves to the author to conceal more than to reveal.

Vezgishi's K reminds you of Jozef K, (anti) hero of Franc Kafka's novel "Process" (1925), where the shortened last name represents the blurry, half anonymous, disfiguring identity within the narration which reveals the fate of an individual caught by the ruthless social machinery that follows him, persecutes, judges and finally kills him like a dog, without even understanding the reason behind his mess ... Pavilion K is the image of a similar narrative of a complete catch of the K place, because even the other word in the phrase, being thus the pavilion, reminds you of an exhausting definitions of its use like prison pavilion, hospital pavilion, or asylum pavilion.

This interpretation might even be considered subjective, assumptive. However, even the other path of analysing the mister of K, which is closer to the context of visual Arts,

ENG

even though abstract, in a way leads you towards that direction. In this way K is the marking of the square as a key element in Vezgishi's work since the first works as a visual artist, and is inevitable even in other fields where he was challenged as an architect, interior designer, theatre director, set designer, graphic designer, etc.

The squares in Pavilion K are always present as constructive elements and as applying intervention. They don't appear only in abstract works in the manner of Malevich's black or white square, but also in 'non-geometric' installations, for e.g. in the outfits of the series *Wings of Desire*, where in each one of them we find at least one square which is not part of the original sewing, but Vezgishi intervened in it, they are part of additional sewing.

'Additional' squares might be considered as quotations from Malevich's suprematist doctrine, whom Vezgishi owes in his work.¹

This brings us back to the question in the beginning on the conceptual link between the abstract paintings (*Squares*, *Tower*, *Roth_Ko*) and installations which can't be easily reduced to geometric shapes? Actually, even the installation *K place* is constructed by big square tables of sponge mattresses as a resemblance of Albanian odas where men discuss sitting cross-legged. The installation *Flag and Bricks*; 1969, also has squares as a constructive element. However, for these installations, just like for *Wings of Desire*, the core shouldn't be searched in geometry, but in social narration which dominates the exhibition as a whole.

The title itself, *Wings of Desire*, transmits the idea of metaphorical meaning of 20th century costumes 'fashion show', because they are costumes of modernity, or part of society's longing to catch the pace with civilisation, but this intention remains incomplete, unfinished. The outfits of the installation, as the most dynamic element which is present

1. Ekspozita Paviloni K. në këtë aspekt dallon shumë nga ekspozita paraprake e Vezgishit Bardh në galerinë 'Zeta' (Tiranë, 2016), që e tërëqë në homazh abstrakcionit suprematist të Maleviçit. Kalimthi po e përmendi edhe faktin se të ekspozita në 'Zeta' Vezgishi e ka ndarë hapësirën me Matilda Odobashin, e cila tani, në Pavilonin K., e ka rolin e kuratores.

in the entire space of the pavilion, embeds the metaphor of duality: they were sewn according to the expressive and beautiful samples, but they look sad and scary as remains of 'poem of misery' due to the inability of implementation. Maybe Vezgishi hints towards 'outfits' with progressive ideology, promising equality and freedom, however, by feeding the ambition of "soul engineers" and the creation of the "new human" by any cost, even with violence, have completed as colossal deception, by "sliding" in them totalitarisms and inhuman regimes.

Pavilion K is a museum of illusions that represents the century efforts of illumination and modernisation for our human to "dress" in costumes of rationality and improvement with esthetical qualities, but that failed because the project is compromised and degraded. Vezgishi shows the degradation in today's world by ironising its building substance, like in the flag built by plastic bags, poll with stupid furniture, "K place" by artificial sponge. Just like in Wittgenstein's motto you have in the beginning of this text, also in Pavilion K, its reading looks legitimate in an artistic manner as much as in ethical one.

K-AUTONOMY

Tevfik Rada

Është e diele pasdite dhe ti shkon në galeri për ta parë ekspozitën e re që është hapur nga një artist vendor i cili me siguri jeton jashtë vendit. E shikon artin konceptual apo instalacionin të cilin artisti e ka prodhuar dhe në shikim të parë nuk e kupton. Të duket sikur forma e artit nuk ka pas ndonjë histori andaj edhe është e vështirë të vihet në kontekst. Pastaj, e shikon titullin apo përshkrimin që i është vënë veprës së artit dhe papritmas çdo gjë merr kuptim. Përshkrimi të tregon se “nën” konstruksionit jo-historik gjendet një pajisje e cila në moment e ndërlidh shikuesin me idenë e paramenduar. Kjo ide mund të vijë nga ndonjë kujtim traumatik të cilin e ka përjetuar artisti, mund të jetë referencë ndaj politikës tiranike e cila ka shtypur një mori identitetesh, ndonjë homazh për ndonjë ngjarje të dhimbshme, etj. Në momentin kur e kupton idenë e veprës, e cila në fillim është dukur shumë hutuese, është koha t’i kërlesh edhe veprat tjera përreth.

Në një artikull të kohëve të fundit në lidhje me estetikën e singularitetit, Frederic Jameson flet për efekte të ngjashme të cilat i ka arti bashkëkohor si logjikë kulturore në kohën e kapitalizmit global dhe post-modernizmit. Nëse e marrim shembullin e tij paradigmatic nga arti i instalacionit, ai thekson se arti bashkëkohor funksionon mbi idenë e “ngjarjeve formale që ndodhin një herë dhe nuk përsëriten”. Vendi të cilin pasioni modernist për inovacion të formës e merr nga format jetëshkurtra të cilat nuk to të zhvillohen më tej në veprat artistike të ardhshme të artistit. Rregulli i ri i estetikës është të “konsumohet” ideja e veprës së artit, në vend se të fokusohet në materialitetin e saj. Andaj, marrëdhënia materiale dhe ndërtimi i veprave të artit nuk janë më materiale (së paku ashtu siç i dimë që nga Duchamp dhe më vonë Konceptualizmi), nevojitet një ide e veçantë, apo madje edhe një tregim personal për t’i mbajtur së bashku (Konceptualizëm i dobësuar?!). Vepra e artit mund të qëndrojë në këmbët e veta për shkak të këtij triku. Këtë trik Jameson e quan marifet: “...’çdo pajisje e vogël e përdorur në mënyrë sekrete nga një magjistar gjatë performimit të trikut’: andaj as ky nuk është atributi më i mirë, edhe pse në një vepër të tillë kjo është shpikja që ndodh një herë, e një pajisjeje që godet një herë.

Por megjithatë, është një pajisje që funksionon një herë e cila duhet të hidhet tutje pasi që triku – singulariteti – është performuar..¹

ALB

Nuk kemi nevojë që domosdo të jemi plotësisht kritik ndaj këtyre veprave të artit të cilat ndërtohen mbi truqe. Ky trik, mendoj, mund të jetë edhe një intervenim estetik dhe politik, i cili e parandalon shikuesin për të thënë “aha!”, duke e komplikuar kështu situatën edhe më tej. Apo ta thotë të kundërtën, gjë që mund të na mundësojë ta shohim komplikimin e situatës. Jameson u mundua ta qartësojë logjikën kulturore të kapitalizmit global duke e marrë artin bashkëkohor dhe aspektin momental të tij si shembull të paradigmës. Andaj, ai është më shumë i interesuar në strukturën historike, të kristalizuar si art bashkëkohor, se sa në gjetjen e “veprave të mira të artit” (çka do që mund të nënkuptojë kjo, por padyshim jo veprat e Damien Hirst apo Xu Bing të cilat i diskuton).

Arsyeja pse desha të filloj me “marifetin” (apo sido që e quajmë) është të tregoj çka nuk janë veprat e Maksut Vezgishit. Ai ka punuar për dekada të tëra në zhvillimin e idesë së njëjtë dhe eksperimentit formal. Kjo me siguri e afron atë më afër me artistin bashkëkohor se sa me atë post-bashkëkohor. Në veprat e tij ka padyshim disa truqe, por ato janë luajtur në një mënyrë tjetër. Ato i rezistojnë interpretimit të lehtë historik dhe narrativizmit, ato nuk sillen përreth kujtimeve personale të artistit apo statusit të tij si imigrant. Pas veprave të tij nuk fshihet ndonjë “tregim” që na bën të themi “aha!”. Prandaj, mendoj se efektet të cilat i shkaktojnë veprat e tij janë të shumta dhe me kohëzgjatje më të gjatë në përjetimin e tyre estetik. Truqet të cilat i kanë veprat e Vezgishit janë të një natyre tjetër. Në fillim, i shikon veprat dhe të japin përshypje se vepra po të fton të zbulosh çka ka pas saj. Ajo të fton të mendosh se mund të ndërlidhet lehtësisht me një narracion më të thellë, qoftë ai personal apo historik. Në shikim të dytë, e kupton se veprat në fakt nuk kanë ndonjë narracion dhe se e tërheqin pas ftesën të cilën duket se e kanë ofruar në shikim të parë. Ky refuzim të kthen prapa në sipërfaqen e veprës, në

1. Fredric Jameson: Estetika e Singularitetit. New Left Review 92, mars-prill 2015. New Left Review. P 113

formën dhe kompozicionin e saj. Mendoj se duke e bërë këtë ato e mundin edhe historizimin e çastit edhe diskursin e lehtë narrativ. E tërë ekspozita, që nga titulli e deri te përfshirja e formave arkitektonike ka një logjikë të ngjashme provokuese, në motivet e të cilës do të fokusohem më shumë në vazhdim. Edhe pse shumica e veprave të tij i rezistojnë historisë dhe parapëlqejnë të merren me forma gjeometrike, nuk do të thotë se nuk mund të historizohen.

Përkohshmëria hapësinore

Pasi që veprat për të cilat po flasim nuk merren me çështje biografike, propozoj ta bëjmë të njëjtën gjë, ta marrim ekspozitën si një ngjarje të vetme.

Veprat e Vezgishit, në kuptimin formal kanë një logjikë të largimit. Ato e largojnë veten nga përdorimi kulturor. Ta marrim shembullin e abstraksioneve të tij “arkitektonike”. “K”-ja, e cila është e vendosur në hyrje të ekspozitës në një plan akritektonik, së paku në shikim të parë. Pastaj e kuptojmë se kjo është arkitekturë minus dizajni; apo arkitekturë minus përdorueshmëri. Ajo nuk është objekt dizajni i gatshëm për tu pranuar nga klienti apo përdoruesi. Ajo është një eksperiment formal i cili qëndron i zhveshur nga struktura. Edhe serinë e “Krahëve të dëshirës” mund ta shikojmë përmes të njëjtës logjikë. Sërat dhe rrobat e varura në mur na përkujtojnë instalacionin e Joseph Beuys-it “Felt Suit” (1973). Rrobat e Vezgishit nuk janë objekte të shkëlqyera e të dëshiruara të modës. Ato janë modeste dhe madje disa nga to janë të klasës punëtore. Megjithatë, ajo që i intereson artistit këtu nuk është përdorimi i tyre kulturor dhe historik. Më parë është loja me kompozicionin e rrobave, dekonstruktimi dhe ri-konstruktimi i tyre në mënyrë që të shihen format dhe nivelet gjeometrike. Të krijosh një pikturë pa i përdorur brushat dhe ngjyrat: të pikturosh me mjete tjera.

Titulli, “Pavijoni K”, përmban në vete një lloj provokim të caktuar që është prezent pothuaj se në secilën vepër. Dikush mund të mendojë se ai është simbol i ndonjë objekti apo i referohet ndonjë ngjarje apo ideje tjetër. Ai mund të jetë “Kosova”, “Kazimir”, “Kopje”, “Katorr”, etj. Pastaj e vëren se ekziston një numër i pakufishëm i mundësive dhe se veprat e

artit të cilat po i shikon janë rezistente ndaj kuptimit simbolik. E kjo nënkupton se ato refuzojnë të simbolizohen nga titulli (apo nga çka do tjetër). Titullin duhet ta kuptojmë si pjesë të ekspozitës. Unë besoj se “K”-ja nuk qëndron për asnjë simbol i cili i referohet ndonjë gjëje: përkundrazi, ajo qëndron në të njëjtën hapësirë ku qëndrojnë veprat e artit. Ajo është pjesë e serisë së abstrakteve të Vezgishit. Mu sikur katrori i zi, edhe “K”-ja e ka ekzistencën e vet autonome. Disa nga titujt e veprave individuale të artit gjithashtu rrjedhin nga ky abstraksion: “K”, “K-vendi”, “1969”, “Roth-K”, “Oda”, “K-tori”. Duket sikur gjatë eksperimentimit me forma gjeometrike, fjalët janë detyruar në purifikim dhe abstraksion. Nëse operacioni i artistit ka qenë i suksesshëm ose jo, kjo është plotësisht çështje tjetër. Gjëja që është me rëndësi është se ka pasur një përpjekje për ta bërë këtë, qoftë ajo e vetëdijshme apo e pa-vetëdijshme.

“K”-ja si ekzistencë autonome! Do ta marr një shembull nga një poet Futurist rus (nuk ka nevojë të përmendet se Vezgishi është ndikuar nga avangarda ruse, kryesisht nga Malevich-i dhe Tatlin-i) dhe ta bëj një krahasim të vogël. Poeti, poemën e të cilit do ta riprodhoj quhet David Burliuk. Poema e tij, *Treni i Dimrit* (Winter Train), daton që nga viti 1914:

The mountainous beginning of icy declinations
 The path of snows = the routes of whiting
 Frost = bites = a sting
 And the tension of bestial tendons
 The hissing of steam
 The flight of distant sparks
 Fumes vanishing
 disk
 R.²

2. Poema është marrë nga: Harte, Tim. *Fast Forward: Estetika dhe Ideologjia e Shpejtësisë në Kulturën Avangarde Ruse, 1910-1930*. Universiteti i Wisconsin Press, 2009. P. 92

Malet fillojnë me zbritje të akullta
 Shtegu i borës = shtigjet e bardhësisë
 Ngricë = kafshime = thumbim
 Dhe tensioni i tejzave të egra
 Fërshëllime e avullit
 Fluturimi i shkëndijave të largëta
 Tymi zhduket
 disku
R.

E mora mu këtë shembull për shkak të shkronjës së fundit të poemës (R). Poema e kopjon lëvizjen e trenit që zhduket me format e saja. Poema jo vetëm që i përshkruan përpjekjet e trenit në malet me borë, por ajo që është më me rëndësi, ajo krijohet ashtu që duket sikur fjalët dhe shkronjat janë në lëvizje. Poema e largon veten deri sa e arrin abstraksionin minimal: R.

Arsyeja pse e zgjodha këtë poemë është për të treguar përkohshmërinë e ndryshme të “K”-së dhe të “R.”-së; përkohshmëria e ndryshme e abstraksionit. Poema e Burliuk-ut ka një lëvizje agresive me logjikën e përkohshme. Poema, mu si treni, e ndan peizazhin në gjysmë dhe vazhdon të lëviz përpara deri sa e prodhon një “R.”: kjo është përkohshmëria e të ardhmes. Përkundrazi, abstraksioni i Vezgishit ka një logjikë hapësinore. Ato nuk tregojnë kah e ardhmja e as nuk janë në lëvizje. Ato qëndrojnë në të tashmen si një strukturë statike hapësinore. Madje edhe në aspekt simbolik, në të gjitha përshkrimet e veprave mund të shihet viti i njëjtë: 2018. Vepra e tij e quajtur “1969” e krijon një kontrast zbulues kur vendoset afër “2018” në përshkrim. Në “1969” shohim se secila tullë e rëndë (prodhuar në vitin 1969) është në qese plastike. Ky intervenim i sjell tullat e rënda në lehtësinë e së tashmes. Qeset plastike e absorbojnë rëndesën e kohës dhe historisë, duke e kthyer atë në kompozicion hapësinor. Mund të mendojmë t’i vëmë katrorët e zinj afër boshtit të ventilatorit përmes të njëjtës logjikë. Katrori dhe boshti i ventilatorit ndihmojnë që të anulohet historia e tyre.

Avangarda minus Revolucioni

Është interesant të shihet se si arti perëndimor në prodhim dhe teori e imitoi, apo u mundua ta imitojë avangardën ruse gjatë tërë shekullit të njëzetë.

Kazimir Malevich, si edhe Futuristët tjerë (dhe Konstruktivistët), i ka krijuar veprat e tij gjatë viteve të 1910-ta dhe 1920-ta, të cilat ishin shumë kontradiktore dhe me plot energji. Mund të thuhet se kjo energji është energjia e njëjtë që çoi drejt rrëzimit të regjimit carist dhe formimit të revolucionit të parë socialist. Në vitet 1920-ta, ndikimi i katrorit ishte shumë i fuqishëm dhe avangarda evropiane, që nga Bauhaus e deri te De Stijl, e mirëpriti atë si një formë universale revolucionare. Gjatë kohës së kundër-revolucionit të viteve 1930-ta, universalizmi abstrakt i avangardës u dëbua në harresë dhe “katrori u largua përjetësisht në azil”.³ Gjatë këtyre viteve, Alfred Barr, themeluesi i Muzeut të Artit Bashkëkohor i bleu disa nga veprat e Malevich-it. Katrori ishte i gatshëm të bëhej ikonë kulturore. “Katrori, si abstraksion gjeometrik, i pa-përfaqësuar, u bë prototip i artit “të pastër” dhe “të vërtetë”, i cili si eksperimental dhe “i avancuar” mund të lulëzonte vetëm në demokracinë politike.”⁴

Katrori i Malevich-it kishte ndikim te shumica e artistëve abstrakt në Amerikë: që nga Barnett Newman e deri te Ad Reinhardt dhe Mark Rothko. Në vitin 1960s, edhe Arti Amerikan dhe Evropian u ndikua nga Konstruktivistët. Kjo çoi drejt çështjes së neo-avangardës dhe mundësisë së përsëritjes së avangardës historike në kushte të ndryshme politike (ato të kapitalizmit të Luftës së Ftohtë). Çka nënkupton ta përsërisësh Suprematizmin? Ta përsëritësh katrorin e zi? Apo si mund të përsëriten pa u bërë ikonë e vdekur kulturore? Në vitet 1960-ta në Evropë dhe botën anglo-folëse nuk kishte shumë libra apo informata mbi Malevich-in dhe avangardën ruse. Libri me ndikim i Camilla Gray-t “Eksperimenti rus në art: 1863-1922” u publikua në vitin 1962. Prandaj, përsëritja e avangardës nënkuptonte (dhe besoj ende

3. Buck-Morss, Susan. Bota e ëndërrave dhe Katastrofa: Kalimi i Utopisë së Masës në Lindje dhe Perëndim. MIT, 2002. 88

4. ibid.

vazhdon) ta hulumtosh raportin e saj me të tashmen dhe ta ri-mendosh energjinë e saj formale dhe politike. Prandaj, të mendosh për aktualitetin e avangardës kërkon përpjekje të ngjashme me të menduarit e aktualitetit të revolucionit në kushtet e tanishme. Sipas fjalëve të John Roberts-it: “trashëgimia e avangardës duhet të ri-mendohet dhe të rindërtohet disa herë në kontekste kombëtare dhe kulturore, pothuaj se në të njëjtën mënyrë si vetë tradita revolucionare”.⁵

Dhoma e fundit në “Pavijonin-K”, pavijoni drejtkëndësh brenda pavijonit. Dy kostume, ndoshta të lëna nga një artist i cili hyri në fabrikë shumë dekada më parë për të bashkëpunuar me punëtorët, e të cilat qëndrojnë kundruall njëra tjetrës. Janë disa reproduktime të katrorëve të zinj nën njërin nga kostumet. Kësaj radhe katrorët nuk janë perfekt. Një sasi e ngjyrës së tyre ka rrjedhur dhe ka krijuar një shteg në sipërfaqe; njëri nga ta është shtrembëruar në mënyrë formale. Katrorët refuzojnë në kopjohen. Vezgishi, në mënyrë simbolike përpiket ta gjejë energjinë e jashtme të katrorit dhe avangardës historike. Sipërfaqja e deformuar është një përpjekje për tu larguar nga kulturalizimi i veprës së tij.

5. Roberts, John. Koha Revolucionare dhe Avangarda. Verso, 2015.

